STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 5 nëntor 2012

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON SE PUNA E NDERTIMIT RIFILLON NE VENDIN E QENDRES BOTERORE TREGTARE

Ekipet përfundojnë heqjen e ujit në Memorialin dhe Muzeun e 9/11

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se puna e ndërtimit në Qendrën Botërore Tregtare ka rifilluar dhe se rreth 750 punëtorë ndërtimi janë kthyer që të vazhdojnë punën e tyre në Vendin Zero (Ground Zero). Ekipet janë duke rifilluar punën e rëndësishme të ndërtimit tani që më shumë se 95% e rredhjeve të stuhisë në vendin me 16 akra është hequr me pompa. Sot është gjithashtu dita e parë që nga Uragani Sendi (Hurricane Sandy) që vinçat e mëdhenj po përdoren në Qendrën Botërore Tregtare Një dhe në qendrën e tranzitit PATH.

Përveç kthimit të punëtorëve të ndërtimit, Guvernatori njoftoi përfundimin me sukses të operacionit masiv të heqjes me pompa që ishte duke u kryer në Memorialin dhe Muzeun Kombëtar të 11 shtatorit në Vendin Zero (Ground Zero). Rreth 16 milionë gallona ose shtatë këmbë ujë përmbytën Muzeun natën e të hënës gjatë stuhisë.

Sapo e lejuan kushtet e sigurisë, ekipe nga Autoriteti Portual i Nju Jorkut dhe Nju Xhërsit dhe kontraktorët e tyre, se bashku me Korpusin e Inxhinierëve të Ushtrisë së SHBA-së, filluan të heqin me pompa ujin nga Muzeu pa ndalim. Ekipet tani do të fillojnë të përqëndrohen në heqjen e sasive të vogla të ujit që mbeten në zona të izoluara, si dhe pastrimin e mbeturinave.

Guvernatori njoftoi të shtunën se ekipet përfunduan heqjen e ujit nga Qendra Botërore Tregtare Një, shtratin e shinave të PATH dhe Qendrën e Sigurisë të Automjeteve (VSC), që është nga ku rrjedhja e stuhisë hyri në vend. Ekipi i Ndërtimit të WTC të Autoritetit Portual, që është përgjegjës për punën, njofton se presin të përfundojnë heqjen e ujit në qendrën e tranzitit PATH brenda 24-48 orëve të ardhshme. Qendra është operacioni i fundit i madh i heqjes me pompa që vazhdon në vend.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shteti i Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418

Albanian